

**KOPSHTI PUBLIK PËR FËMIJË „SNEZHANA“ –
i Komunës së Çairit - Shkup**

RREGULLORE
PËR SISTEMIMIN
E VENDEVE TË PUNËS

Shkup, qershor 2019

Në bazë të nenit 17 paragrafi (7) të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18), neni 116 paragrafi (1) alineja (8) të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 23/13, 12/14, 44/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18, 104/19), Ligji për përdorimin e gjuhëve (Gz zyrtare e RMV nr. 07/19) dhe nenin 26 paragrafi (1) alineja (8) nga Statuti i IPKKF "SNEZHANA" Çair – Shkup, Këshilli drejtues i IPKKF "SNEZHANA" Çair – Shkup në seancën e mbajtur me datë _____2019, solli:

RREGULLORE

për sistemimin e vendeve të punës në IPKKF "SNEZHANA" – i Komunës së Çairit në Qytetin e Shkupit

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet numri i të punësuarve (nëpunës administrativ, dhënës të shërbimeve, persona ndihmës - teknik) orari, shifrimi, titulli dhe përshkrimi i vendeve të punës për njësi organizative, kushte të veçanta të nevojshme për realizimin e punëve dhe detyrave të vendeve të caktuara të punës në IPKKF "SNEZHANA" – i Komunës së Çairit në Qytetin e Shkupit.

Neni 2

Punët dhe detyrat të cilat kryhen në IPKKF "SNEZHANA" – i Komunës së Çairit, përcaktohen në pajtim me përkatësinë e tyre, ndërlidhja mes tyre, lloji, vëllimi dhe shkalla e kompleksitetit, përgjegjësia dhe kushtet tjera për realizimin e tyre.

Neni 3

Punët dhe detyrat e përcaktuara me këtë Rregullore paraqesin bazë për punësim dhe përcaktimin e të punësuarve në IPKKF "SNEZHANA" – i Komunës së Çairit.

Neni 4

Në IPKKF "SNEZHANA" janë sistemuar gjithsej 27 vende pune në të cilët janë përndarë gjithsej 96 realizues (shërbimi administrativ ndihmës teknik, shërbimi profesional, shërbimi edukativ-përkujdesës, njësia organizative - objekt).

Neni 5

Pasqyra tabelore (harta e punës) e vendeve të punës në IPKKF “SNEZHANA” – i Komunës së Çairit në Qytetin e Shkupit është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje dhe është në shtojcë të së njëjtit.

I. SHËRBIMI ADMINISTRATIV DHE PERSONELI NDIHMËS TEKNIK

1. Shërbimi administrativ ndihmës teknik

I.1.1. Njësia administrative

Neni 6

Në njësinë administrative janë përcaktuar dhe paraparë gjithsej 4 vende pune, të cilat i kryejnë 4 nëpunës administrativ të përndarë në njësinë administrative dhe menaxhim me resurset njerëzore, në pajtim me Rregulloren për parimet e organizimit të brendshëm të IPKKF “Snezhana” – i Komunës së Çairit.

Vendet e punës nga neni 6 i kësaj rregullore janë në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativ dhe janë përndarë në këtë mënyrë:

- Niveli V1 - 2
- Niveli V2 - 1
- Niveli G4 - 1

Kushtet e përgjithshme

Neni 7

Për plotësimin e vendeve të punës në institucionet publike për fëmijë nëpunësit administrativ duhet që ti përmbushin kushtet e përgjithshme dhe të veçanta.

Kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për nëpunës administrativ janë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- në mënyrë aktive ta përdorë gjuhën maqedonase
- të jetë i moshës madhore
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kushtet e veçanta

Neni 8

(1) Kushtet e veçanta të përcaktuara me Ligjin për nëpunës administrativ për nëpunësit profesional të kategorisë V janë:

- Kualifikime profesionale dhe atë:
 - për nivelin V1 shkalla e kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të arritura sipas ECTS ose të kryer shkallën e VII/1 të arsimit
 - për nivelin V2 shkalla e kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura ose 240 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën e VII/1 të arsimit
- njohja aktive e njërës nga tre gjuhët më të përdorura të Bashkimit evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- njohje aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë
- përvojë pune dhe atë:
 - për nivelin V1 së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion
 - për nivelin V2 së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

(2) Kompetenca të nevojshme të përgjithshme punuese të nivelit të mesëm:

- zgjedhja e problemeve dhe vendimmarrje për punët nga fushëveprimi i tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- realizim i rezultateve
- punë me të tjerët / punë ekipore
- vetëdije strategjike
- orientim drejt klientëve/ palët e prekura dhe
- menaxhim financiar

Neni 9

(1) Kushtet e veçanta të përcaktuara me Ligj për nëpunësit administrativ ndihmës – profesional të kategorisë G janë:

- Kualifikime profesionale dhe atë:

për nivelin G1 të shkallës së kualifikimeve profesionale VA ose të shkallës së kualifikimeve IV sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe 180 ose 240 kredi të arritura sipas ECVET / SKMAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm
- njohje aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë
- përvojë pune dhe atë:

Për nivelin G4 me ose pa përvojë pune në profesion
- njohja aktive e njërës nga tre gjuhët më të përdorura të Bashkimit evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

(2) Kompetenca të nevojshme të përgjithshme punuese të nivelit bazë:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- realizim i rezultateve
- punë me të tjerët / punë ekipore
- orientim drejt klientëve/ palët e prekura dhe
- menaxhim financiar

I.1.2. Njësia ndihmëse teknike

Në njësinë ndihmëse teknike janë përcaktuar dhe përshkruar gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) vende pune të personave ndihmës teknik me gjithsej 35 realizues, të përndarë në 4 (katër) nën grupe.

Neni 10

Vendet e punës nga neni 10 i kësaj rregulloreje janë përndarë në këtë mënyrë:

(persona ndihmës teknik për mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjes)

- Niveli AO1 – 15

(persona ndihmës teknik për transport të personave dhe pajisjes)

- Niveli AO1 – 1

(persona ndihmës teknik në kuzhinë)

- Niveli AO1 – 1

- Niveli AO2 – 1

- Niveli AO3 – 1

- Niveli AO4 – 4

(persona tjerë ndihmës teknik)

- Niveli AO1 – 3

Kushtet e përgjithshme

Neni 11

Për plotësimin e vendeve të punës në institucionet publike për fëmijë personat ndihmës teknik duhet që ti përmbushin kushtet e përgjithshme dhe të veçanta.

Kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve për personat ndihmës teknik janë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- të jetë i shëndoshë fizikisht dhe psiikisht
- ta njohë gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik

- të mos i është shqiptuar ndalesë sanksionimi penal për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- të mos i jetë shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën është gjykuar për vepër penale për dhunë familjare, marrja e personit të mitur ose incest, për vepër penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pa marrë parasysh shqiptimin e sanksionit dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese
- Të përmbushin edhe kushte tjera të përcaktuara në aktin për sistemimin e brendshëm të vendeve të punës.

Kushtet e veçanta

Neni 12

Kushtet e veçanta të përcaktuara për persona ndihmës teknik të grupit 1 (persona ndihmës – teknik për mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjes) të kategorisë A janë:

- Kualifikime profesionale, dhe atë:
Për nivelin A01, me së paku të shkallës së kualifikimeve IV 240 kredi të arritura sipas Sistemit evropian kreditor në arsimin profesional dhe trajnim (ECVET) ose Sistemi kreditor maqedonas për arsim të përgjithshëm (SKMAP) ose arsim të mesëm katërvjeçarë
- me ose pa përvojë pune

Kushtet e veçanta të përcaktuara për persona ndihmës teknik të grupit 3 (persona ndihmës – teknik për transport të personave dhe udhëtarëve) të kategorisë A janë:

- Kualifikime profesionale, dhe atë:
Për nivelin A01, me së paku të shkallës së kualifikimeve IV 240 kredi të arritura sipas Sistemit evropian kreditor në arsimin profesional dhe trajnim (ECVET) ose Sistemi kreditor maqedonas për arsim të përgjithshëm (SKMAP) ose arsim të mesëm katërvjeçarë
- me ose pa përvojë pune

Kushtet e veçanta të përcaktuara për persona ndihmës teknik të grupit 4 (persona ndihmës – teknik në kuzhinë) të kategorisë A janë:

- Kualifikime profesionale, dhe atë:
Për nivelin A01, me së paku të shkallës së kualifikimeve IV 240 kredi të arritura sipas Sistemit evropian kreditor në arsimin profesional dhe trajnim (ECVET) ose Sistemi kreditor maqedonas për arsim të përgjithshëm (SKMAP) ose arsim të mesëm katërvjeçarë
- me ose pa përvojë pune
 - për nivelin A02 me nivel më të ulët të kualifikimit III, 180 kredi sipas Sistemit evropian kreditor në arsimin profesional dhe trajnimin (ECVET) ose arsim të mesëm trevjeçarë dhe përvojë pune, dhe atë:
 - pa përvojë pune.

- për nivelin A01 të nivelt të parë (më kryerje të arsimit fillor ose të mesëm) ose sipas kornizës Maqedonase të kualifikimeve dhe të arritura 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SKMAP

- me ose pa përvojë pune.

- për nivelin A04 të nivelt të katërt (më kryerje të arsimit fillor ose të mesëm) ose sipas kornizës Maqedonase të kualifikimeve dhe të arritura 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SKMAP

- me ose pa përvojë pune.

Kushtet e veçanta të përcaktuara për persona ndihmës teknik të grupit 5 (persona tjerë teknik) të kategorisë A janë:

- Kualifikime profesionale, dhe atë:

Për nivelin A01, me së paku të shkallës së kualifikimeve IV 240 kredi të arritura sipas Sistemit evropian kreditor në arsimin profesional dhe trajnim (ECVET) ose Sistemi kreditor maqedonas për arsim të përgjithshëm (SKMAP) ose arsim të mesëm katërvjeçarë

- me ose pa përvojë pune

II DHËNËSIT R SHËRBIMEVE

1. Shërbimi profesional

Neni 13

Me këtë rregullore përcaktohen dhe përshkruhen gjithsej 13 vende pune në shërbimin profesional me gjithsej 13 realizues, të përndarë në njësi për punëtorë profesional dhe njësia për bashkëpunëtor profesional.

II.1.1.Njësia për punëtor profesional

Neni 14

Vendet e punës të punëtorëve profesional janë përndarë në kategorinë B. Në korniza të kategorisë B janë përcaktuar këto nivele:

- niveli B3 – 4

II.1.1.Njësia për bashkëpunëtor profesional

Neni 15

Vendet e punës të bashkëpunëtorëve profesional janë përndarë në kategorinë G. Në korniza të kategorisë G janë përcaktuar këto nivele:

- niveli G3 – 1

2. SHËRBIMI EDUKATIV - PËRKUJDESES

Neni 16

Me këtë rregullore janë të përcaktuar dhe përshkruar gjithsej 6 (gjashtë) vende pune në shërbimin edukativ – përkujdesës me gjithsej 59 realizues, të përndarë në njësinë për edukatorë dhe njësinë për përkëdhelëse.

II.2.1. Njësia për edukatorë

Neni 17

Vendet e punës të edukatorëve janë përndarë në kategorinë V.

Në korniza të kategorisë V janë përcaktua këto nivele:

- niveli V2
- niveli V3
- niveli V4

II.2.2. Njësia për përkëdhelëse

Neni 18

Vendet e punës të edukatorëve janë përndarë në kategorinë D.

Në korniza të kategorisë D janë përcaktua këto nivele:

- niveli D2
- niveli D3
- niveli D4

Kushtet e përgjithshme

Neni 19

- (1) Për plotësimin e vendeve të punës në institucionet publike për fëmijë dhënësit e shërbimeve duhet që ti përmbushin kushtet e përgjithshme dhe të veçanta.

Kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe ligjin për përdorimin e gjuhëve për dhënësit e shërbimeve janë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- të jetë i shëndoshë fizikisht dhe psiikisht
- ta njohë gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik

- të mos i është shqiptuar ndalesë sanksionimi penal për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- të mos i jetë shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën është gjykuar për vepër penale për dhunë familjare, marrja e personit të mitur ose incest, për vepër penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pa marrë parasysh shqiptimin e sanksionit dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese
- Të përmbushin edhe kushte tjera të përcaktuara në aktin për sistemimin e brendshëm të vendeve të punës.

(2) aktivitetet edukative arsimore realizohen në gjuhën e përkatësive të bashkësive duhet që ta njohin gjuhën dhe alfabetin në të cilën realizohet veprimtaria.

Kushtet e veçanta

Neni 20

Kushtet e veçanta të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve për dhënësit e shërbimeve janë:

- për nivelin A1- me arsim përkatës sipëror për të punësuarit në radhët e punëtorëve profesional të nivelit B1, B2 dhe B3, gjegjësisht nga radha e edukatorëve të nivelit V1, V2 dhe V3, së paku pesë vjet përvojë pune në institucion, me licencë përkatëse për punë për punëtorë profesional gjegjësisht për edukator.
- për nivelin B1 - pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punëtor social i diplomuar, defektolog i diplomuar / edukator special dhe rehabilitues, logoped i diplomuar, doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë, me arritjen e 240 kredive sipas EKTC ose të kryer shkallën VII/1, licencë të vlefshme për punëtor profesional, me së paku pesë vjet përvojë pune pas diplomimit në profesion.
- për nivelin B2 - pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punëtor social i diplomuar, defektolog i diplomuar / edukator special dhe rehabilitues, logoped i diplomuar, doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë, me arritjen e 240 kredive sipas EKTC ose të kryer shkallën VII/1, licencë të vlefshme për punëtor profesional, me së paku tre vjet përvojë pune pas diplomimit.
- për nivelin B3 - pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punëtor social i diplomuar, defektolog i diplomuar / edukator special dhe rehabilitues, logoped i diplomuar, doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë, me arritjen e 240 kredive sipas EKTC ose të kryer shkallën VII/1, licencë të vlefshme për punëtor profesional, me së paku një vjet përvojë pune në profesion.
- për nivelin B4 - pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punëtor social i diplomuar, defektolog i diplomuar / edukator special dhe rehabilitues, logoped i diplomuar, doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë, me arritjen e 240 kredive sipas EKTC ose të kryer shkallën VII/1, licencë të vlefshme për punëtor profesional, me/pa përvojë pune.

- për nivelin V1 - edukatorë për fëmijë mbi moshën dy vjeçare deri në moshën gjashtë vjeçare, gjegjësisht deri në fillimin e shkollimit fillor (profesor i diplomuar i edukimit parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve t[ë moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar) me arritje të 240 kredive sipas EKC ose kryerjen e arsimit sipëror shkalla VII/1 dhe edukatorë për qëndrim të fëmijëve të moshës deri gjashtë vjet, gjegjësisht nga fillimi në shkollë fillore deri në moshën 10 vjeçare (profesor i diplomuar i edukimit parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me arritjen e 240 kredive sipas EKC ose kryerjen e arsimit sipëror shkalla VII/1 ose person me studime të kryera për mësim klasor shkalla VII/1 dhe të jenë me licencë të vlefshme për edukator dhe së paku pesë vjet përvojë pune pas diplomimit në profesion.

- për nivelin V2 - edukatorë për fëmijë mbi moshën dy vjeçare deri në moshën gjashtë vjeçare, gjegjësisht deri në fillimin e shkollimit fillor (profesor i diplomuar i edukimit parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve t[ë moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar) me arritje të 240 kredive sipas EKC ose kryerjen e arsimit sipëror shkalla VII/1 dhe edukatorë për qëndrim të fëmijëve të moshës deri gjashtë vjet, gjegjësisht nga fillimi në shkollë fillore deri në moshën 10 vjeçare (profesor i diplomuar i edukimit parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me arritjen e 240 kredive sipas EKC ose kryerjen e arsimit sipëror shkalla VII/1 ose person me studime të kryera për mësim klasor shkalla VII/1 dhe të jenë me licencë të vlefshme për edukator dhe së paku tre vjet përvojë pune pas diplomimit në profesion.

- për nivelin V3 - edukatorë për fëmijë mbi moshën dy vjeçare deri në moshën gjashtë vjeçare, gjegjësisht deri në fillimin e shkollimit fillor (profesor i diplomuar i edukimit parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve t[ë moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar) me arritje të 240 kredive sipas EKC ose kryerjen e arsimit sipëror shkalla VII/1 dhe edukatorë për qëndrim të fëmijëve të moshës deri gjashtë vjet, gjegjësisht nga fillimi në shkollë fillore deri në moshën 10 vjeçare (profesor i diplomuar i edukimit parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me arritjen e 240 kredive sipas EKC ose kryerjen e arsimit sipëror shkalla VII/1 ose person me studime të kryera për mësim klasor shkalla VII/1 dhe të jenë me licencë të vlefshme për edukator dhe së paku një vjet përvojë pune pas diplomimit në profesion.

- për nivelin V4 - edukatorë për fëmijë mbi moshën dy vjeçare deri në moshën gjashtë vjeçare, gjegjësisht deri në fillimin e shkollimit fillor (profesor i diplomuar i edukimit parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve t[ë moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar) me arritje të 240 kredive sipas EKC ose kryerjen e arsimit sipëror shkalla VII/1 dhe edukatorë për qëndrim të fëmijëve të moshës deri gjashtë vjet, gjegjësisht nga fillimi në shkollë fillore deri në moshën 10 vjeçare (profesor i diplomuar i edukimit

parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me arritjen e 240 kredive sipas EKTC ose kryerjen e arsimit sipëror shkalla VII/1 ose person me studime të kryera për mësim klasor shkalla VII/1 dhe të jenë me licencë të vlefshme për edukator me ose pa përvojë pune në profesion.

- për nivelin G1- pedagog i muzikës, pedagog i diplomuar i artit, pedagog i diplomuar i edukatës fizike, kryerje të fakultetit të artit muzikor, fakulteti i edukatës fizike, sport dhe shëndetësi, fakulteti për art figurativ, profesor i diplomuar i gjuhëve të huaja dhe letërsisë, me arritje të 240 kredive sipas EKTC ose të kryer shkallën VII/1, licencë e vlefshme për bashkëpunëtor profesional, me së paku pesë vjet përvojë pune pas diplomimit në profesion.

- për nivelin G2 - pedagog i muzikës, pedagog i diplomuar i artit, pedagog i diplomuar i edukatës fizike, kryerje të fakultetit të artit muzikor, fakulteti i edukatës fizike, sport dhe shëndetësi, fakulteti për art figurativ, profesor i diplomuar i gjuhëve të huaja dhe letërsisë, me arritje të 240 kredive sipas EKTC ose të kryer shkallën VII/1, motër e përgjithshme medicinave, motër e diplomuar medicinave/teknik mjekësor, motër medicinave/teknik, motër e lartë medicinave, me arritje të 180 kredive ose me kryerje të shkallës VII/1, licencë e vlefshme për bashkëpunëtor profesional, me së paku tre vjet përvojë pune pas diplomimit në profesion.

- për nivelin G3 - pedagog i muzikës, pedagog i diplomuar i artit, pedagog i diplomuar i edukatës fizike, kryerje të fakultetit të artit muzikor, fakulteti i edukatës fizike, sport dhe shëndetësi, fakulteti për art figurativ, profesor i diplomuar i gjuhëve të huaja dhe letërsisë, me arritje të 240 kredive sipas EKTC ose të kryer shkallën VII/1, motër e përgjithshme medicinave, motër e diplomuar medicinave/teknik mjekësor, motër medicinave/teknik, motër e lartë medicinave, me arritje të 180 kredive ose me kryerje të shkallës VII/1, licencë e vlefshme për bashkëpunëtor profesional, me së paku një vjet përvojë pune pas diplomimit në profesion.

- për nivelin G4 - pedagog i muzikës, pedagog i diplomuar i artit, pedagog i diplomuar i edukatës fizike, kryerje të fakultetit të artit muzikor, fakulteti i edukatës fizike, sport dhe shëndetësi, fakulteti për art figurativ, profesor i diplomuar i gjuhëve të huaja dhe letërsisë, me arritje të 240 kredive sipas EKTC ose të kryer shkallën VII/1, motër e përgjithshme medicinave, motër e diplomuar medicinave/teknik mjekësor, motër medicinave/teknik, motër e lartë medicinave, me arritje të 180 kredive ose me kryerje të shkallës VII/1, licencë e vlefshme për bashkëpunëtor profesional, me /pa përvojë pune në profesion.

- për nivelin D1 –Fakultet për edukatë fizike sport dhe shëndetësi – studime profesionale për trajner sportiv, shkollë e lart[ë mjekësore – motër e përgjithshme medicinave, Fakulteti i mjekësisë – motra medicinave/teknik, logoped, fizioterapeut, akusherë, me arritje të 180 kredive sipas EKTC ose të kryer shkallën VI, licencë e vlefshme për përkëdhelës dhe së paku pesë vjet përvojë pune në profesion.

- për nivelin D2 – shkollë të mesme katërvjeçare, shkollë e mesme mjekësore, arsim i mesëm – drejtimi gjimnaz, shkollë e mesme e muzikës, shkollë e mesme e artit, shkollë e mesme e fizikulturës, licencë e vlefshme për përkëdhelës dhe së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

- për nivelin D3 – shkollë të mesme katërvjeçare, shkollë e mesme mjekësore, arsim i mesëm – drejtimi gjimnaz, shkollë e mesme e muzikës, shkollë e mesme e artit, shkollë e mesme e fizkulturës, licencë e vlefshme për përkëdhelës dhe së paku një vjet përvojë pune në profesion.

- për nivelin D4 – shkollë të mesme katërvjeçare, shkollë e mesme mjekësore, arsim i mesëm – drejtimi gjimnaz, shkollë e mesme e muzikës, shkollë e mesme e artit, shkollë e mesme e fiskulturës, licencë e vlefshme për përkëdhelës me/pa përvojë pune në profesion.

- për të punësuarit me kryerje të arsimit të lartë shkalla VI/1, me arritjen e 180 kredive sipas EKTC dhe me arsim të mesëm katërvjeçarë – dhënësit e shërbimeve publike, të cilët me ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshim plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 104/2019) kanë punuar në vend pune si edukatorë/bashkëpunëtor profesionalë/përkëdhelës dhe i kanë përmbushur kushtet për vendin përkatës të punës në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta zyrtare e Maqedonisë së Veriut” nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18), munden edhe më tutje ta kryejnë punën në të cilën janë takuar me hyrjen në fuqi të Ligjit për ndryshim plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 104/2019). Të njëjtët munden që ta përtërinë/vazhdojnë licencën përkatëse të arritur për punë.

- Në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve, meqenëse Komuna e Çairit është komunë me mbi 20% të nacionalitetit shqiptarë, për të gjitha nivelet është e nevojshme si kusht i veçantë njohja e gjuhës shqipe dhe alfabetit të saj.

III. NË NJËSITË ORGANIZATIVE - OBJEKT

- Udhëheqës i objektit

Neni 21

Udhëheqësi i objektit emërohet në objekt ku ka mbi dy grupe dhe kapacitet të projektuar të institucionit mbi 100 fëmijë.

Vendi i punës udhëheqës i objektit është caktuar në kategorinë A.

- kategoria A – 2

NJ.P. XHUXHIJA (SHKURTABIQËT)

III.1. Udhëheqës i objektit

III.1. Udhëheqës i objektit – 1

III.1.1. Shërbimi edukativ-përkujdesës

- III.1.1.1. Njësia e edukatorëve
 - niveli V2 - 1
 - niveli V3 - 9
 - niveli V4 - 1
- III.1.1.2.Njësia e përkëdhelësve
 - niveli D2 - 1
 - niveli D3 - 20
 - niveli D4 - 1
- III.1.2.Njësia ndihmëse-teknike
 - niveli A1 - 13
 - niveli A2 - 1
 - niveli A3 - 1
 - niveli A4 - 2

NJ.P. SNEGULKO (FJOLLA)

IV.1. Udhëheqës i objektit

- IV.1. Udhëheqës i objektit – 1
- IV.1.1.Shërbimi edukativ - përkujdesës
- IV.1.1.1.Njësia e edukimit
 - niveli V2 - 1
 - niveli V3 - 9
 - niveli V4 - 1
- IV.1.1.2.Njësia e përkëdhelësve
 - niveli D2 - 1
 - niveli D3 - 13
 - niveli D4 - 1
- IV.1.2.Njësia ndihmëse - teknike
 - niveli A1 - 7
 - niveli A4 - 2

TREGUESI TABELOR I VENDEVE TË PUNËS

I. Shërbimi administrativ dhe personeli ndihmës teknik	
1. Shërbimi administrativ ndihmës teknik	
I.1.1. Njësia administrative	
Numri rendor	1
Shifra	ADM 01 02 V01 001
Niveli	V1
Titulli	Këshilltar – sekretar
Titulli i vendit të punës	Këshilltar – sekretar
Numri i realizuesve	1
Përgjigjet para	Drejtorit
Lloji i arsimit	Shkenca juridike
Kushte tjera të veçanta	-
Qëllimet e punës	Organizimi i punës në departament dhe realizimi i

	veprimtarive nga sfera e së drejtës lidhur me zbatimin e drejtë të ligjeve dhe dispozitave tjera pozitive juridike.
Detyrat dhe obligimet e punës	- I ndjek dhe studion dispozitat ligjore dhe tjera dhe kujdeset për zbatimin e tyre të drejtë; - Përgatit materiale për organet e administrimit dhe materiale tjera të cilat dalin nga konkluzioni i organeve dhe trupave profesionale; - Zbaton dhe jep aktvendime, certifikata, vërtetime në pajtim me dispozitat dhe aktet ligjore të Kopshtit; - Bën pranimin, evidentimin, shpërndarjen, ruajtjen dhe dërgimin e postës dhe ruajtjen e vulës dhe shtembilit të Kopshtit; - Ruajtje dhe udhëheqje të dokumentacionit arkivor; - Mban protokoll të veçantë protokollar nga sfera e mbrojtjes; - Përpilon akte nga pjesa e mbrojtjes në bazë të udhëzimeve, dispozitave ligjore dhe kërkesave nga Ministria e mbrojtjes dhe Agjencisë për ballafaqim me krizat; - Përpilon akte të përgjithshme në pajtim me Statutin e institucionit publik për fëmijë, dispozitave ligjore dhe të njëjtët në kohë i harmonizon në pajtim me ndryshimet e ligjit; - Përpilon dokumente për realizimin e furnizimeve publike nga të gjitha llojet në pajtim me ligjin dhe merr pjesë në përgatitjen e dokumentacionit të tenderit në bashkëpunim me ekonomin dhe drejtorin; - Merr pjesëmarrje aktive në implementimin e standardeve dhe normativave në Kopsht.

I. Shërbimi administrativ dhe personeli ndihmës teknik	
1. Shërbimi administrativ ndihmës teknik	
I.1.1. Njësia administrative	
Numri rendor	2
Shifra	ADM 01 02 V01 002
Niveli	V1
Titulli	Këshilltar – kontabilist
Titulli i vendit të punës	Kontabilist
Numri i realizuesve	1
Përgjegjëset para	Drejtorit
Lloji i arsimit	Shkenca ekonomike
Kushte tjera të veçanta	-

Qëllimet e punës	Ndjekja dhe zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga lëmi i punës buxhetore dhe materiale - financiare
Detyrat dhe obligimet e punës	- E organizon punën e gjithëmbarshme të kontabilitetit në Kopsht; - Rregullisht i ndjek dispozitat ligjore për kontabilitet dhe punë të kontabilitetit dhe në mënyrë të pavarur ndërmerr masa për harmonizimin e punës e kontabilitetit me të njëjtët; - Rregullisht dhe në mënyrë të drejtë e udhëheq evidencën e kontabilitetit; - Merr pjesë në përpilimin e planeve financiare vjetore, mujore dhe kuartale; - Merr pjesë në përpilimin e planit për furnizime publike; - E organizon punën e regjistrimit të mjeteve themelore etj dhe e organizon punën komisionit qendror dhe komisioneve tjera regjistruese; - Përgatit dhe dorëzon raport financiar; - Përpilon propozim raport vjetor financiar për punë financiare të Kopshtit; - Mban libra të faturave hyrëse; - Përpilon fleturdhëresa për pagesë të detyrimeve financiare.

I. Shërbimi administrativ dhe personeli ndihmës teknik	
1. Shërbimi administrativ ndihmës teknik	
I.1.1. Njësia administrative	
Numri rendor	3
Shifra	ADM 01 02 V02 001
Niveli	V2
Titulli	Bashkëpunëtor i lartë
Titulli i vendit të punës	Sekretar
Numri i realizuesve	1
Përgjigjet para	Drejtorit
Lloji i arsimit	Shkencat juridike
Kushte tjera të veçanta	
Qëllimet e punës	Me vetëdije, përgjegjësi dhe profesionalizëm të realizojë veprimtarinë nga sfera e së drejtës.
Detyrat dhe obligimet e punës	- merr pjesë në organizimin e punëve të shërbimit juridik administrativ; - merr pjesë në përpilimin e propozim akteve normative, vendimeve, aktvendimeve dhe akte tjera juridike të cilat i miraton Këshilli drejtues, gjegjësisht drejtori; - sipas nevojës merr pjesë në punën e organeve

	profesionale; - jep aktvendime, certifikata, vërtetime në pajtim me dispozitat ligjore dhe akteve të kopshtit publik për fëmijë; - përpilon raporte përkatëse statistikore për të punësuarit; - merr pjesë në realizimin e dispozitave për furnizime publike; - jep informata të karakterit publik; - bën azhurimin e të dhënave për Mbrojtje; - merr pjesë/mban evidencë përkatëse për pronën e kopshtit publik për fëmijë.
--	--

I. Shërbimi administrativ dhe personeli ndihmës teknik	
1. Shërbimi administrativ ndihmës teknik	
I.1.1. Njësia administrative	
Numri rendor	4
Shifra	ADM 01 02 G01 008
Niveli	G1
Titulli	Referent i ri – Arkëtar
Titulli i vendit të punës	Arkëtar
Numri i realizuesve	1
Përgjegjëset para	Drejtorit
Lloji i arsimit	Arsim të lartë, arsim të mesëm gjimnaz ose arsim të mesëm profesional (drejtimi ekonomik – juridik ose tregtar)
Kushte tjera të veçanta	-
Qëllimet e punës	Ndjekja dhe zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga lëmi i punës së arkës
Detyrat dhe obligimet e punës	- I ndjek dhe zbaton dispozitat ligjore nga puna e arkës të Kopshtit; - E udhëheq arkën dhe manipulon me mjetet në të holla për punën vijuese të Kopshtit dhe përpilon raporte të arkës me shtojcat përkatëse në kontabilitet për regjistrim; - Bën llogari të rrogave bruto dhe neto dhe kompensimeve tjera për të punësuarit dhe dorëzon përlllogari për SPI dhe DAP dhe kryen pagesë të rrogave dhe kompensimeve të të punësuarve; - Bën përlllogaritje të pushimeve mjekësore të së punësuarve dhe mban evidencë të rrogave dhe kompensimeve të të punësuarve; - Merr pjesë në përpilimin e raporteve statistikore për institucionin publik për fëmijë; - Përpilon dhe dorëzon Pasqyrë tatimore vjetore

	deri te DAP; - Mban evidencë analitike për prezencën e fëmijëve, i detyron shfrytëzuesit e shërbimeve-prindërit me fletëpagesë për shlyerjen e detyrimeve ndaj Kopshtit dhe i çaktivizon shfrytëzuesit të cilët i kanë shlyer detyrimet; - Mban evidencë për shlyerjen e borxheve të shfrytëzuesve të shërbimeve – prindërit, ndërsa për prindërit të cilët nuk i kanë shlyer borxhet deri te shërbimi juridik dorëzon raport mujor për ndërmarrjen e masave të mëtutjeshme.
--	--

II. DHËNËSIT E SHËRBIMEVE	
II.1. Shërbimi profesional	
II.1.1. Njësia për punëtor profesional	
Numri rendor	5
Shifra	ADM 03 03 B03 001
Niveli	B3
Titulli	Punëtor profesional
Titulli i vendit të punës	Pedagog i diplomuar
Numri i realizuesve	1
Përgjigjet para	Drejtorit
Lloji i arsimit	Pedagogji
Kushte tjera të veçanta	Licencë të vlefshme për punëtorë profesional
Qëllimet e punës	Planifikim, organizim dhe ndjekje të punës edukative – arsimore me fëmijë
Detyrat dhe obligimet e punës	- e planifikon punën pedagogjike dhe përkujdesëse – edukative dhe merr pjesë në përpilimin e Programit dhe Raportit për punë; - në mënyrë aktive bashkëpunon me edukatorët dhe përkëdhelëset dhe ju jep këshilla profesionale në realizimin e punës përkujdesdëse - edukative; - jep ndihmë profesionale edukatorëve dhe përkëdhelësve në zgjedhje të formave, temave, përmbajtjeve mjeteve arsimore, literaturës për punë me fëmijë. - jep ndihmë profesionale edukatorëve dhe përkëdhelësve gjatë mbajtjes së evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit pedagogjik për grupin edukativ; - në mënyrë të rregullt e mban librin kryesor për regjistrim të fëmijëve dhe merr pjesë në orarin e fëmijëve nëpër grupe edukative; - merr pjesë në planifikimin, organizimin dhe realizimin e përkryerjes profesionale të kuadrit edukativ dhe përkëdhelës;

	-merr pjesë në përpilimin e programit për veprimtari publike dhe kulturore të institucionit publik për fëmijë dhe në realizimin e të njëjtës; -bashkëpunon me prindërit e fëmijëve; - jep ndihmë instruktive – pedagogjike të fëmijëve, prindërve, edukatorëve dhe përkëdhelësve dhe mban evidencë përkatëse, përpilon pasqyra, raporte, rekomandime; - zëvendëson dhe punon në grupe ku mungon kuadri edukativ.
--	---

II. DHËNËSIT E SHËRBIMEVE	
II.1. Shërbimi profesional	
II.1.1. Njësia për punëtor profesional	
Numri rendor	6
Shifra	ADM 03 03 B03 003
Niveli	B3
Titulli	Punëtorë profesional
Titulli i vendit të punës	Punëtor social i diplomuar
Numri i realizuesve	1
Përgjigjet para	Drejtorit
Lloji i arsimit	Punë sociale dhe politikë sociale
Kushte tjera të veçanta	Licencë të vlefshme për punë profesionale, njohja e gjuhës shqipe dhe alfabetit të saj
Qëllimet e punës	Ndjekjen e fëmijëve të familjeve sociale problematike dhe bashkëpunon me shërbime tjera sociale.
Detyrat dhe obligimet e punës	- përpilon program vjetor, plan mujor dhe operativ dhe raport vjetor për punën e tij; - Realizon bashkëpunim të ngushtë me prindërit e fëmijëve të cilët kanë probleme në sjelljen ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, të fëmijëve të prindërve të shkurorëzuar me qëllim që të mbrohet zhvillimi psiko social i fëmijës; - sipas nevojës realizon vizitën në familjet e fëmijëve; - Drejtpërdrejtë realizon bashkëpunim me fëmijët me probleme në sjelljen me qëllim që ta orientojë fëmijën në sjellje të drejtë dhe orientimin në mjedisin në të cilin jeton; - Punon në zbulimin dhe paraqitjen e dhunës familjare dhe keqpërdorimin fizik dhe psikik të fëmijëve; - drejtpërdrejtë punon me fëmijë me aftësi të kufizuara; - merr pjesë në punën e komisionit për pranimin e fëmijëve me aftës të kufizuara; - në mënyrë aktive bashkëpunon me edukatorët dhe

	përkëdhelëset dhe ju jep këshilla profesionale për punën me fëmijët të cilët kanë probleme në sjelljen; - mban dosje për fëmijët me të cilët punon; - realizon bashkëpunim të ngushtë me institucionet për mbrojtje sociale të fëmijëve.
--	--

II. DHËNËSIT E SHËRBIMEVE	
II.1. Shërbimi profesional	
II.1.1. Njësia për punëtor profesional	
Numri rendor	7
Shifra	ADM 0303 B03 004
Niveli	B3
Titulli	Punëtor profesional
Titulli i vendit të punës	Defektolog i diplomuar (edukator dhe rehabilitues special)
Numri i realizuesve	1
Përgjigjet para	Drejtorit
Lloji i arsimit	Defektologji
Kushte tjera të veçanta	Licencë e vlefshme për punëtor profesional
Qëllimet e punës	Preventiva, identifikimi, korrigjimi dhe kompensimi i pengesave specifike në zhvillimin psiko motorik, sensorik dhe socio emocional tek fëmijët.
Detyrat dhe obligimet e punës	-punon në zbulimin dhe ndjekjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara; -merr pjesë në punën e Komisionit për pranimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara; - merr pjesë në përpilimin e Programit vjetor (Planit akcional) për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe përpilon plane individuale arsimore për fëmijë me aftësi të kufizuara; -bën trajtim individual defektologjik të fëmijëve me aftësi të kufizuara; - i ndjek analizat dhe evidenton efekte të planit individual edukativo-arsimor nga puna me fëmijët me aftësi të kufizuara; - punon në organizimin dhe realizimin e bashkëpunimit të hapur me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara; - jep përkrahje dhe orientime të edukatorëve dhe përkëdhelësve të cilët në grupe kanë fëmijë me aftësi të kufizuara; - në mënyrë aktive bashkëpunon me drejtorin, pedagogun, psikologun, punëtorin social, mjekun-pediatrin, edukatorët dhe përkëdhelësit; - mban evidencë për punën e tij dhe dorëzon raport vjetor deri te drejtori i kopshtit;

II. DHËNËSIT E SHËRBIMEVE	
II.1. Shërbimi profesional	
II.1.1. Njësia për punëtor profesional	
Numri rendor	8
Shifra	ADM 03 03 B03 005
Niveli	B3
Titulli	Punëtor profesional
Titulli i vendit të punës	Logoped i diplomuar
Numri i realizuesve	1
Përgjigjet para	Drejtorit
Lloji i arsimit	Arsim (Logopedi), Shkencat mjekësore (Logopedi)
Kushte tjera të veçanta	Licencë të vlefshme për punë profesionale, njohja e gjuhës shqipe dhe alfabetit të saj
Qëllimet e punës	Zbulim, preventivë dhe mënjanimi i formave patologjike në komunikimin verbal, sjellje dhe mësim tek fëmijët në procesin edukativo – arsimor.
